

## **Koronavirus – Këshilla rajonale për Shtetin Federal të Saksonisë**

### **Si po proçedojnë zyrat?**

Sipas të dhënave aktuale të Këshillit të Refugjatëve të Saksonisë punojnë të gjitha zyrat. Zyrat e Punës (Jobcenter dhe Arbeitsagentur) nuk ofrojnë më takime personale. Për to është e mundur vetëm shërbimi online.

### **Aksesi në arsim?**

Shkollat dhe institucionet arsimore në Saksoni janë për momentin të mbyllura. Po ashtu edhe kopshtet. Ministria e Çështjeve Sociale nuk është prononcuar ende për datën e rihapjes së tyre.

Ekziston mundësia mbi përkujdesjen e fëmijëve në raste emergjence. Por kjo vetëm në rastin kur prindërit punojnë në profesione të rëndësishme. Sipas Ministrisë së Çështjeve Sociale këto profesione përfshijnë psh. mjekët, policët ose punonjësit e heqjes së plehrave.

### **Kujt ti drejtohem në rastin e shfaqjes së simptomave?**

**E RËNDËSISHME:** Në rastin e shfaqjes së simptomave të Koronavirusit, MOS u paraqisni tek mjeku. Telefononi një nga numrat Hotline të vënë në dispozicion. Nëpërmjet tyre ju kontaktoni me Drejtorinë e Shëndetësisë. Është e rëndësishme, të telefononi me drejtorinë përgjegjëse për rajonin ose qytetin ku banoni.

Mund të kontaktoni nëpërmjet telefonit edhe mjekun ose mjeken e familjes. Ato do tu japin informacionin e nevojshëm.

Hotline në Chemnitz: 0371 488 53 21

Hotline në Dresden: 0351 488 53 22

Hotline në Leipzig: 0341 123 68 52, nga e hëna deri të dielë, ora 8.00 – 18.00

Hotline në Rrethin e Zwickau: 0375 44 02 21 111

Hotline në Rrethin e Erzgebirge: 03733 83 13 008

Hotline në Rrethin e Bautzen: 03591 52 52 12 12 1

Hotline në Rrethin e Görlitz: 03581 66 35 65 6

Hotline në Rrethin e Meißen: 03521 72 53 435 email: [corona@kreis-meissen.de](mailto:corona@kreis-meissen.de)

Hotline në Rrethin e Sächsische Schweiz/Osterzgebirge: 03501 515 11 77

Hotline në Rrethin e Leipzig: 03437 984 55 66

Hotline në Rrethin e Nordsachsen: 03421 758 55 55 / 03421 758 55 56, nga e hëna deri të dielë, ora 8.00 – 18.00

Gjëndja në 16 mars: Nuk ekzistojnë Hotline për rrethet e Mittelsachsen dhe Vogtland.

Të dhënat për zyrat përkatëse janë si vijon:

Drejtorja e Shëndetësisë Mittelsachsen: 03731 79 6249 / [gesundheit@landkreis-mittelsachsen.de](mailto:gesundheit@landkreis-mittelsachsen.de)

Drejtorja e Shëndetësisë Vogtland: 03741 300 35 00 / [zenker.kerstin@vogtlandkreis.de](mailto:zenker.kerstin@vogtlandkreis.de)

### **Si të veprojmë në karantinë? Kërkesat e parashtruara?**

Këshilli i Refugjatëve në Saksoni (Sächsische Flüchtlingsrat e.V. - SFR) ka kontaktuar me Ministrinë e Brendshme. SFR shpreson, që qendrat e para të pritjes së azilkërkuesve në:

Hamburger Straße në Dresden

Bremer Straße në Dresden

Grillenburg

Max-Liebermann-Straße në Leipzig

Dölzig

Adalbert-Stifter-Ëeg në Chemnitz

Flemminger Straße në Chemnitz

Thüringer Ëeg në Chemnitz

Schneeberg

të mos vendosen në karantinë. SFR shpreson që, njerëzit që ndodhen në to të transferohen sa më parë në rrethe administrative dhe qytete. Duhet të krijohet mundësia e akomodimit të njerëzve në hostele apo hotele. Pa dallim, nëse personat janë apo jo të sëmurë.

Por ekzistojnë edhe qendra të tjera të mëdha në Saksoni. Ato janë qendrat e akomodimit të azilkërkuesve, që u takojnë rrethëve administrative dhe qyteteve. Përshembull qendra e akomodimit në Torgauer Straße në Leipzig. Edhe në këtë rast SFR shpreson, që njerëzit e akomoduar aty, të zhvendosen në hostele ose hotele.

Kjo gjë i është komunikuar Ministrisë së Brendshme nga ana e SFR. Shpresojmë për një informacion të shpejtë dhe të përkthyer në gjuhë të ndryshme.

INFORMACIONE AKTUALE mund të gjeni në kanalën mediatic MDR Sachsen. Për fat të keq informacionet janë vetëm gjermanisht.

Për Rajonin e Dresden (qyteti i Dresden, Rrethi i Meißen, Rrethi i Sächsische Schweiz/Osterzgebirge): <https://www.mdr.de/sachsen/dresden/corona-ueberblick-dresden-landkreis-meissen-saechsische-schweiz-osterzgebirge-100.html>

Për Rajonin e Leipzig (qyteti i Leipzig, Rrethi i Leipzig, Rrethi i Nordsachsen): <https://www.mdr.de/sachsen/leipzig/corona-ueberblick-leipzig-nordsachsen-landkreis-leipzig-100.html>

Për Rajonin e Chemnitz (qyteti i Chemnitz, Rrethi i Mittelsachsen, Rrethi i Zwickau, Rrethi i Erzgebirge, Rrethi i Vogtland): <https://www.mdr.de/sachsen/chemnitz/corona-chemnitz-mittelsachsen-zwickau-erzgebirgskreis-vogtland-100.html>

Për Rajonin e Oberlausitz (Rrethi i Bautzen, Rrethi i Görlitz): <https://www.mdr.de/sachsen/bautzen/coronavirus-oberlausitz-100.html>